

20110912207

## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Në bazë të nenit 30 dhe nenit 47 paragrafi 1 alineja 6 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010), Këshilli i Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

### **VENDIM PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN ME TË CILAT LEJOHET RIPRODHIMI I KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

1. Me këtë vendim përcaktohet mënyra dhe procedura me të cilat lejohet riprodhimi i kartëmonedhave dhe monedhave të cilat i emiton Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore).

2. "Riprodhimi", sipas këtij vendimi nënkupton çdo imazh material ose jomaterial të kartëmonedhës dhe monedhës së plotë ose pjesës së saj, ose pjesës individuale të elementeve të dizajnit, si ngjyra, madhësia, letrat dhe simbolet, përdorimi i të cilave mund duket ose ti ngjajë kartëmonedhës dhe monedhës, pavarësisht:

- madhësia e imazhit,
- materiali dhe teknika e prodhimit,
- elementet e shtuara të cilat nuk janë të përfshira në versionin origjinal, ose
- ndryshimi i bërë në dizajn.

3. Ky vendim zbatohet për kartëmonedhat dhe monedhat të cilat janë mjete ligjore për pagesë në Republikën e Maqedonisë dhe që janë në qarkullim, si dhe për kartëmonedhat dhe monedhat e tërhequra nga qarkullimi, afati i zëvendësimit i të cilave ende nuk ka mbaruar.

#### **II. LËSHIMI I LEJES PËR RIPRODHIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE**

4. Riprodhimet për të cilat publiku mund të ketë përshtypjen se janë kartëmonedha dhe monedha origjinale nuk lejohen.

5. Për përgatitjen e riprodhimit të kartëmonedhave dhe monedhave, përveç atyre të përmendura në pikën 10 të këtij vendimi, është e nevojshme leje me shkrim nga Banka Popullore.

6. Leja nga pika 5 e këtij vendimi jepet në bazë të kërkesës së parashtruar me shkrim për riprodhim. Kërkesa parashtrohet nga urdhëruesi i riprodhimit ose nga prodhuesi i tij, nëse ai e përdor riprodhimin.

7. Kërkesa për marrjen e lejes për riprodhimin e kartëmonedhave dhe monedhave duhet ti përmbajë elementët në vijim:

- përshkrim i detajuar i riprodhimit, arsye për nevojën e riprodhimit të kartëmonedhave dhe monedhave, numri i copave sipas strukturës së emërimit, llojit dhe karakteristikave të materialit prej të cilëve do të bëhet riprodhimi;
- ekzemplar ose imazh i riprodhimit duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.

8. Kur vendoset për lejen për riprodhim, Banka Popullore veçanërisht do të shqyrtojë nëse riprodhimi mund të shkaktojë konfuzion në lidhje me kartëmonedhat dhe monedhat origjinale.

9. Projekt-vendimi për dhënien e lejes për riprodhimin e kartëmonedhave dhe monedhave përgatitet nga komisioni i themeluar nga Guvernatori i Bankës Popullore.

Vendimin për dhënien e lejes për riprodhimin e kartëmonedhave dhe monedhave e miraton Guvernatori i Bankës Popullore.

### **III. KRITERET PËR RIPRODHIMET E LEJUARA TË KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE**

10. Riprodhimet e kartëmonedhave dhe monedhave mund të bëhen edhe pa lejen e Bankës Popullore, në rastet kur nuk ka rrezik për publikun, bëhet fjalë për autenticitetin e kartëmonedhave dhe monedhave dhe kur plotësohen disa nga kushtet e mëposhtme:

- vetëm në pamjen e përparme ose në pamjen e prapme të kartëmonedhës, me kusht që riprodhimi i njëanshëm të jetë më i madh se 125% ose më i vogël se 75% të gjatësisë dhe gjerësisë së kartëmonedhave.
- në pamjen e përparme ose në pamjen e prapme në tërësi, me kusht që ajo pjesë të jetë më e vogël se një e treta pamjes së përparme ose e pamjes së prapme të kartëmonedhave,
- në madhësi më të madhe se 200%, ose më të vogël se 50% të gjatësisë dhe gjerësisë së kartëmonedhave,
- në element individual të dizajnit të kartëmonedhave, me kusht që elementi të paraqitet në një sfond i cili është plotësisht i ndryshëm nga sfondi i kartëmonedhave,
- të përgatitur me teknikë të zezë dhe të bardhë, pavarësisht nga dimensionet e kartëmonedhave,
- riprodhimet jomateriale në formë elektronike të cilat mundësojnë qasjen e publikut tek ata, ku zgjidhja e rezulucioni i kartëmonedhave dhe monedhave nuk i kalon 72 pika për inç (dpi),
- të monedhave më të mëdha se 100%, ose të monedhave më të vogla se 50%,
- riprodhimi i cili është bërë nga materiali i cili dukshëm dallohet nga letra dhe që është dukshëm ndryshe nga materiali i përdorur për përgatitjen e kartëmonedhave dhe monedhave.

11. Riprodhimet e kartëmonedhave dhe monedhave nuk guxojnë të përpunohen nëse pamja e përgjithshme ose pjesët individuale të riprodhimit fyejnë reputacionin e Republikës së Maqedonisë dhe të Bankës Popullore.

12. Sa herë që Banka Popullore vë re riprodhimin e paautorizuar të kartëmonedhave dhe monedhave, riprodhimin e paautorizuar të disponueshëm në mënyrë elektronike në ueb lokacionet ose në media të tjera në dispozicion të publikut, ajo do të ndërmarrë veprime sipas Nenit 115 të Ligjit për Bankën Popullore.

**V. DISPOZITA PËRUNDIMTARE**

13. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

V. nr. 02-15/VII-10/2011  
30 qershor viti 2011  
Shkup

Guvernator dhe Kryetar  
i Këshillit të Bankës Popullore  
të Republikës së Maqedonisë,  
Dimitar Bogov